VENDIM
Nr. 55, datë 16.7.2018

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN "PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT QENDROR TË REGJISTRIMIT DHE SHLYERJES SË TITUJVE (AFISaR)"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "c" dhe të nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)", miratuar me vendimin nr. 76, datë 18.12.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, shtohet pika 83 me përmbajtje si më poshtë:

"E drejtë për aksesimin e informacionit është e drejtë që u jepet përdoruesve të nominuar nga një institucion/organ për të hyrë dhe për të lexuar informacion në sistemin AFISaR, në përputhje me qëllimin e ligjit që u jep të drejtën për akses.".

b) Në nenin 26, pika 2, shkronja "d", riformulohet si më poshtë:

"Llogari teknike për të cilat nuk paguhet komision:

i. llogaria e nivelit tavan të tregtimit që është llogaria në emër të një pjesëmarrësi të sistemit AFISaR, por që nuk është një pjesëmarrës në sistemin AIPS, e për rrjedhojë, do të përdorë llogarinë e një pjesëmarrësi tjetër që është agjent shlyerës në sistemin AIPS;

ii. llogaria e klientëve është llogari në emër të një pjesëmarrësi që ka kapacitetet e përcaktuara në nenin 15, pika 2, shkronja "d", në rastin kur Ministria ka vendosur kufizime në pjesëmarrjen e tregut primar. Kjo llogari përdoret për të pasqyruar në ankandin e tregut primar, kërkesat e të gjithë klientëve. Pas shpërndarjes së kërkesave fituese në llogaritë përkatëse të klientëve, kjo llogari duhet të zerohet në ditën e shlyerjes së veprimeve të ankandit.".

c) Në nenin 50, shtohet pika 5/2, me përmbajtje si më poshtë:

"Komisionet për institucionet/organet që kanë të drejtën e aksesimit të informacionit përfshijnë:

a) Komision për pajisjen e aksesit në sistemin AFISaR;

b) Komision për çdo kërkim informacioni në sistemin AFISaR.

Komisionet sipas shkronjës "a" paguhen me marrjen në dorëzim të pajisjes së aksesit, ndërsa komisionet sipas shkronjës "b" paguhen në bazë mujore sipas faturës dhe informacionit të detajuar të dërguar nga administratori".

d) Pas nenit 75, shtohet neni 75/1, me titull "E drejta për aksesimin e informacionit", me përmbajtje si më poshtë:

"1. Institucionet/organet që me ligj kanë të drejtë të aksesojnë informacionin mbi investimet në tituj shtetërorë nga ana e personave juridikë/fizikë direkt nga sistemet që zotërojnë këtë informacion, mund të kërkojnë të drejta për aksesimin e informacionit në sistemin AFISaR.

2. Institucionet/organet e përcaktuara në pikën 1, marrin të drejta për aksesimin e sistemit AFISaR, vetëm për leximin e informacionit për aq sa i lejon ligji.

3. E drejta për aksesimin e informacionit jepet nga administratori i sistemit AFISaR, pas:

a) Paraqitjes së kërkesës të mirargumentuar ligjërisht për marrjen e të drejtave për aksesimin e informacionit në sistemin AFISaR;

b) Paraqitjes të "Rregullave të brendshme për kontrollin e lëvizjes së informacionit sekret";

c) Paraqitjes së kërkesës për përdorues në VPN, pajisje sigurie dhe certifikatë digjitale sipas pikave 1, 2, 3 të shtojcës 19 të kësaj Rregulloreje;

d) Pagesës së kostove për sigurimin e së drejtës për aksesimin e informacionit, në rast se ka të tilla;

e) Nënshkrimit të marrëveshjes tip sipas shtojcës 20 të kësaj Rregulloreje;

f) Institucionet/organet të cilat aksesojnë sistemin nëpërmjet VPN-së, krahas detyrimeve të përcaktuara më sipër në këtë pikë, duhet të:

i. hartojnë procedurat e të tyre të brendshme për sigurinë dhe për mbrojtjen e informacionit, duke përfshirë procedurat organizative (burimet njerëzore dhe pajisjet) dhe ato informatike (për elementet *hardware* dhe *software*), në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje;

ii. kenë akses të përshtatshëm për mjetet digjitale të telekomunikimit, për konfigurimet e duhura të

autenticitetit dhe të mjeteve të sigurisë, si dhe të garantojnë që ekziston siguria që funksionimi i sistemit AFISaR nuk do të jetë subjekt i ndërhyrjeve të shkaktuara nga faktorët e brendshëm apo të jashtëm.

4. Pas plotësimit të kërkesave sipas pikës 3, administratori kryen procedurat për dhënien e të drejtave për aksesimin e informacionit në sistemin AFISaR, si dhe krijon përdoruesit përkatës.

5. Në rast se administratori konstaton shkelje të kësaj Rregulloreje apo të kushteve të sigurisë së informacionit, ndërpret të drejtat për aksesimin e informacionit në sistemin AFISaR, duke njoftuar me shkrim institucionin/organin.

6. Administratori njofton institucionin /organin për ndryshime në Rregulloren e AFISaR që e prekin atë.".

e) Pas shtojcës 19, shtohet shtojca 20, me titull "Marrëveshje tip për dhënien e të drejtave për aksesimin e informacionit në sistemin AFISaR", bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

f) Përmbajtja e shtojcës 8 me titull "Komisionet e aplikuara në sistemin AFISaR" ndryshon sipas përmbajtjes së shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Të autorizojë Drejtorin e Departamentit të Operacioneve Monetare të nënshkruajë "Marrëveshjen tip për dhënien e të drejtave për aksesimin e informacionit në sistemin AFISaR", sipas përmbajtjes së shtojcës 20.

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në Bankën e Shqipërisë, si dhe pjesëmarrësit e sistemit AFISaR.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Gent Sejko

SHTOJCA 8
KOMISIONET E APLIKUARA NË SISTEMIN AFISaR

Lloji i komisioneve	Në vlerë (lekë)	Në përqindje
A. Komision për anëtarësim dhe mirëmbajtje		
Komision hyrjeje (anëtarësimi) për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë	250,000	
Komision hyrjeje (anëtarësimi) për pjesëmarrësit e tërthortë	0 (zero)	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e tërthortë (persona juridikë) me llogari titulli në Bankën e Shqipërisë	250,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë	250,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për Bursën e Titujve	100,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e tërthortë me llogari titulli në pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë përveç Bankës së Shqipërisë*	150,000	
Komision daljeje	0 (zero)	
B. Komision për operacionet e veçanta		
Komision (1) procesimi për operacionet DVP (shitje/blerjet, kredi brenda ditës me Bankën e Shqipërisë dhe transaksioni i kthimit, marrëveshje riblerjeje/të anasjella riblerjeje me Bankën e Shqipërisë dhe transaksioni i anasjelltë)	350	
Komision (2) procesimi për operacionet DVP (marrëveshje riblerjeje/të anasjella riblerjeje dhe transaksioni i anasjellë të ndryshme nga ato me Bankën e Shqipërisë)	200	
Komision procesimi për operacionet FOP (transfertat e portofolit, transaksionet midis llogarisë vetjake të	350	

* Ky komision faturohet dhe mblidhet nga pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë dhe më pas i transferohet Bankës së Shqipërisë.

pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë dhe llogarisë së një pjesëmarrësi të tërthortë që është klient i të njëjtit pjesëmarrës së drejtpërdrejtë, transaksionet midis dy pjesëmarrësve që kanë të njëjtin agjent shlyerës në AIPS, ekzekutimi i kolateralit, zëvendësimi i titullit në një marrëveshje riblerjeje, transaksionet për të plotësuar kërkesën për marzhin e ruajtjes së vlerës së titullit të tregtuar nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes)		
Komision për procesimin e rezultateve të tregut primar (emetim, maturim, ankand rihapjeje, ankand për blerjen mbrapsht të titullit)	200	
Komision për operacionet e netimit sipas modelit DVP2 për transaksionet e tregut primar	150	
Komision për procesimin e pagesës së interesave të përfituara nga investimi në titujt	1200	
Komision për procesimin e marrëveshjeve të kolateralit financiar (regjistrimi i kolateralit, lirimi i kolateralit)	350	
Komision për kthimin e kuponëve nga rishitësi te riblerësi në një marrëveshje *repo/reverse repo*	350	
Komision për riciklimin e transaksioneve të tregut primar	0 (zero)	
Komision për procesimin e operacioneve që rrjedhin nga thirrja e titujve, nga ankandet e marrëveshjeve të riblerjes/të anasjella riblerjeje të Ministrisë së Financave, nga taksimi i titujve	0 (zero)	
C. Komisione të tjera		
Përgatitja e raporteve sipas kërkesës specifike	Për t'u vlerësuar në bazë të kërkesës specifike	
Komisione për trajnimin e operatorëve të sistemit	0 (zero)	
Komision për certifikimin e operatorëve të sistemit	0 (zero)	
Komision për pajisjen e aksesit në sistemin AFISaR	3 (tre) për pjesëmarrës falas, të tjerat me pagesë, sipas kostos së pajisjes. Për institucionet/organet pajisja është me pagesë.	
Komision për kërkimin e informacionit nga institucioni /organi	50 lekë për çdo kërkim	
D. Zbritjet për të inkurajuar procesimin		
Për vëllimin e procesuar	0 (zero)	
Për kohën e procesimit	0 (zero)	

SHTOJCA 20
MARRËVESHJA TIP PËR DHËNIEN E TË DREJTAVE PËR AKSESIMIN E INFORMACIONIT NË SISTEMIN AFISaR

MARRËVESHJE
PËR TË DREJTAT PËR AKSESIMIN E INFORMACIONIT NË SISTEMIN AFISaR
(ALBANIAN FINANCIAL SETTLEMENT AND REGISTRATION SYSTEM)

Palët:

Banka e Shqipërisë, në cilësinë e Administratorit të Sistemit AFISaR (më poshtë referuar si "Administratori"), me adresë: sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar në këtë marrëveshje nga z. Marian Gjermeni, Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare,

Dhe _____, në cilësinë e "Institucionit/organit me të drejta për aksesimin e informacionit" (më poshtë referuar si "institucioni/organi"), me adresë: _____, përfaqësuar në këtë marrëveshje nga z/zj. _____,

bien dakord të lidhin këtë marrëveshje sipas kushteve të mëposhtme,

Neni 1
Objekti i marrëveshjes

Objekti i marrëveshjes është përcaktimi i të drejtave dhe i detyrimeve të palëve, të cilat lindin në kuadrin e ofrimit të së drejtës për aksesimin e informacionit në sistemin AFISaR, nga Banka e Shqipërisë si pronar dhe administrator i vetëm i këtij sistemi, si dhe të institucionit/organit, në statusin e përdoruesit të informacionit të gjeneruar në këtë sistem, në përputhje me qëllimin e ligjit që i jep këtë të drejtë përdoruesit, si dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje dhe të rregullores përkatëse.

Neni 2
Baza ligjore

1. Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
2. Ligjit nr.____ (ligji i institucionit/organit në momentin e lidhjes së marrëveshjes);
3. Rregullorja "Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 76, datë 18.12.2014, i ndryshuar (në vijim referuar si "Rregullorja").

Neni 3
Përkufizime dhe interpretime

1. Termat e përdorur në marrëveshje kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në Rregullore.
2. "Dokumentacioni" është tërësia e rregullave që rregullojnë sistemin AFISaR, ku përfshihen: rregullorja dhe manuali i përdorimit të sistemit AFISaR.
3. Çdo kusht ose dispozitë e marrëveshjes, që mund të sjellë paqartësi interpretohet në kontekstin e ligjeve, Rregullores dhe në këndvështrimin e qëllimit për të cilin palët lidhin këtë marrëveshje.
4. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë marrëveshje, zbatohen dispozitat e Rregullores dhe, në rast se këto të fundit nuk rregullojnë çështje të veçanta, zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të fushës të cituara edhe në bazën ligjore të Rregullores.

Neni 4
Kërkesa

1. Kërkesa, së bashku me dokumentet e kërkuara sipas Rregullores, të dorëzuara nga institucioni/organi, i bashkëlidhen marrëveshjes dhe janë pjesë përbërëse e saj.
2. Informacioni që kërkohet të monitorohet është:
a) Gjendja aktuale e llogarisë së personit fizik/juridik;
b) Historiku i lëvizjeve të llogarisë së personit fizik/juridik.

Neni 5
Mjeti dhe format e komunikimit

1. Për aksesimin e informacionit të sistemit AFISaR, institucioni/organi përdor si mënyrë komunikimi VPN-në.
2. Administratori, pasi aprovon mënyrën e komunikimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, detajon specifikimet teknike të komunikimit në përputhje me Rregulloren.

Neni 6
Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Administratori dhe institucioni/organi kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcaktohen në Rregullore, e cila është e detyrueshme për t'u zbatuar.

Neni 7
Komisionet e pjesëmarrjes

Institucioni/organi duhet të paguajë komisionet e përcaktuara në Rregullore për të pasur të drejtë për aksesimin e informacionit në sistemin AFISaR. Institucioni duhet të marrë masat e nevojshme për të përmbushur këtë detyrim pa vonesa kohore.

Neni 8
Konfidencialiteti

Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të dhënë në mënyrë reciproke, duke bërë përpjekjet maksimale për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur numrin e personave që disponojnë këtë informacion.

Neni 11
Masa administrative

Administratori ka të drejtë të ndërpresë aksesin në përputhje me dispozitat e Rregullores në rast se institucioni/organi nuk e ushtron veprimtarinë në përputhje me Rregulloren, me dokumentacionin, si edhe me instruksionet e dhëna prej tij.

Neni 12
Ndryshimet e marrëveshjes

Kushtet e marrëveshjes ndryshohen me nënshkrimin e të dyja palëve.

Neni 13
Forca madhore

Palët nuk janë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve kontraktore për shkak të forcës madhore, për të cilën njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën.

Neni 14
Njoftimet

1. Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër formal ndërmjet palëve, me përjashtim të komunikimit të përcaktuar në nenin 5 të kësaj marrëveshje kryhet me postë zyrtare të regjistruar, faks, *e-mail* ose në rast pamundësie, kryhet me telefon.
2. Në rast se njoftimi, kërkesa ose komunikimi mbërrin tek i adresuari pas orës 16:30, ai konsiderohet i marrë në orën 08:30 të ditës pasardhëse të punës.
3. Palët njoftojnë njëra-tjetrën për ndryshimet e mundshme të adresave, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga ndryshimi i tyre.
4. Palët njoftojnë njëra-tjetrën menjëherë për ndryshimet e mundshme të përfaqësuesve të tyre.

Neni 15
Zgjidhja e marrëveshjes

1. Palët mund të zgjidhin marrëveshjen me mirëkuptim ose në mënyrë të njëanshme për mospërmbushje të detyrimeve të rëndësishme, duke njoftuar me shkrim njëra-tjetrën të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës që ato dëshirojnë ta zgjidhin atë duke kërkuar plotësimin e detyrimeve financiare të maturuara, të cilat mund të rrjedhin nga kjo marrëveshje
2. Për të gjitha rastet e tjera të zgjidhjes së kësaj marrëveshjeje që nuk parashikohen në të, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 16

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve, në zbatim të kësaj marrëveshje dhe që nuk zgjidhen me mirëkuptim, zgjidhen pranë gjykatës kompetente.

Neni 17

Të fundit

1. Marrëveshja nënshkruhet në 2 (dy) njësi origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban nga një njësi.

2. Marrëveshja, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur.

Për Bankën e Shqipërisë: Për _____

Marian Gjermeni
Drejtor i Operacioneve Monetare

_____